

LIGJ

Nr. 8928, date 25.7.2002

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "KONVENTEN PER NDALIMIN OSE KUFIZIMIN E PERDORIMIT TE ARMEVE, TE QUAJTURA KONVENCIONALE, TE CILAT MUND TE SHKAKTOJNE DEMTIME TE MEDHA OSE PASOJA PA DALLIM", GJENEVE, 10 TETOR 1980, SI DHE NE PROTOKOLLET SHTESE TE SAJ

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventen për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve, të quajtura konvencionale, të cilat mund të shkaktojnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim", Gjeneve, 10 tetor 1980.

Neni 2

Republika e Shqipërisë aderon në protokollet shtesë të kësaj Konvente;

1. Protokoli I "Për ciflat e pazbulueshme", Gjeneve, 10 tetor 1980.
2. Protokoli II "Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të minave, minave-kurthe dhe mjeteve të tjera shpërthyes", Gjeneve, 10 tetor 1980, ndryshuar me 3 maj 1996.
3. Protokoli III "Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve zjarrvënës", Gjeneve, 10 tetor 1980.
4. Protokoli IV "Për armet verbuese me rreze lazer", Gjeneve, 10 tetor 1980, ndryshuar me 13 tetor 1995.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3427, date 7.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA

MBI NDALIMIN OSE KUFIZIMIN E PERDORIMIT TE ARMEVE TE QUAJTURA
KONVENCIONALE, TE CILAT MUND TE KONSIDEROHEN SE SHKAKTOJNE
DENTIME TE MEDHA OSE PASOJA PA DALLIM

Gjeneve, 10 tetor 1980

Palet e Larta Kontraktuese,

Duke kujtuar se çdo Shtet ka per detyre, ne perputhje me Karten e Kombeve te Bashkuara, te mos kryeje ne marredheniet e tij nderkombetare asnje akt kercenimi ose perdorimi force kunder sovranitetit, teresise tokesore apo pavaresise politike te ndonje Shteti ose ndonje akt tjetet te papajtueshen me qellimet e Kombeve te Bashkuara, Duke kujtuar, gjithashtu, parimin e pergjithshem te mbrojtjes se popullsise civile nga pasojat e veprimeve ushtarake,

Duke u bazuar ne parimin e te drejtes nderkombetare qe e drejta e Paleve ne nje konflikt te armatosur per te zgjedhur metodat apo menytrat e luftes nuk eshte e pakufizuar dhe ne parimin qe ndalon perdorimin ne konflikte te armatosura te armeve, predhave, si dhe materialeve te metodave luftarake qe shkaktojme demtime masive ose vuajtje te panevojshme,

Duke kujtuar gjithashtu qe eshte e ndaluar te perdoren metoda ose menytra luftimi qe kane, synojne apo pritet qe te shkaktojne deme te medha ne shtrirje te gjere territoriale, me afat te zgjatur kohor, si dhe me demtime te theksuara te mjedisit natyror , Duke konfirmuar vendosmerine e tyre qe ne çeshtjet qe nuK parashikohen nga kjo Konvente dhe nga protokollet e saj shtese ose nga marreveshje te tjera nderkombetare, popullsia civile dhe palet nderluftuese do te mbeten perhere nen mbrojtjen dhe autoritetin e parimeve te se drejtes nderkombetare qe rrjedhin nga tradita e vendosur, nga parimet e humanizmit dhe imponimi i ndergjegjes politike,

Duke di!shiruar qe te kontribuojne ne uljen globale te tensionit, dhenien fund te gares se armatimeve dhe njekohesisht, ne ndertimin e mirekuptimit e mirebesimit midis Shteteve dhe, per pasoje, ne realizimin e aspirates se te gjithë popujve per te jetuar ne paqe, Duke njohur rendesine e realizimit te çdo perpjekjeje, e cila mund te kontribuojte perparimin drejt ,armatimit te pergjithshem dhe perfundimtar, nen kontro!lin e rrepte dhe te efektshem nderkombetar,

Duke ripohuar nevojën per te vazhduar kodifikimin dhe zhvi!limin progresiv te rregu!lave te se drejtes nderkombetare qe aplikohen ne nje konflikt te armatosur , Duke pasur deshiren per te ndaluar ose kufizuar per me tej perdorimin e disa armeve konvencionale dhe duke pasur besimin se rrezultatet pozitive te arritura ne kete kuader mund te lehtësojne dialogun kryesor mbi ,armatimin me synim dhenien fund te prodhimit, grumbu!limit dhe shtimit te armeve te tilla,

Duke theksuar deshiren qe te gjitha Shtetet te behen Pale ne kete Konvente dhe protoko!let e saj shtese, ve,anerisht Shtetet me potencial te rendesishem ushtarak, Duke mbajtur parasysh se Asambleja e pergjithshme e Kombeve te Bashkuara dhe Komisioni i Kombeve te Bashkuara per çarmatimin mund te vendose te shqyrtoje çeshtjen e zgjerimit te mundshem te fushes se ndalimit dhe kufizimeve te parashikuara ne kete Konvente dhe ne protokollet e saj shtese,

Duke mbajtur gjithashtu parasysh se Komiteti per çarmatimin mund te vendose per te marre ne konsiderate ,eshtjen e adaptimit te metejshem per ndalimin dhe kufizimin e perdorimit te armeve te ashtuquajtura konvencionale,

Rane dakord per sa me poshte:

Neni 1

Fusha e zbatimit

Kjo Konvente dhe protokollet e saj shtese do te zbatohen ne situatat qe parashikohen ne nenin 2, qe jane te njejta me Konventat e Gjeneves te dates 12 gusht 1949 per Mbrojtjen e Viktimave te Luftes, duke perfshire çdo shtate te pershkruar ne paragrafin 4 te nenit 1 te protokollit 1 Shtese te kesaj Konvente.

Neni 2

Lidhjet me marreveshjet e tjera nderkombetare

Asgje ne kete Konvente ose ne protokollet e saj shtese nuk do te interpretohet si terheqje nga detyrimet e tjera te Paleve te Larta Kontraktuese sipas te drejtes nderkombetare humanitare te aplikueshme ne konfliktet e armatosura.

Neni 3

Nenshkrimi

Kjo Konvente do te jete e hapur per nenshkrim per te gjitha Shtetet ne seline e Kombeve te Bashkuara ne Nju Jork per nje periudhe dymbedhjet mujore nga data 10 prill 1981.

Neni 4

Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Kjo Konvente i nenshtrohet ratifikimit, pranimit, ose miratimit nga Palet Nenshkruese. Shtetet qe nuk kane firmosur ne kete Konvente mund te aderojne ne te.
2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do te depozitohen tek Depozituesi.
3. Shprehja e pelqimit per te pranuar detyrimet qe rrjedhin nga ndonje prej protokolleve qe i bashkengjiten kesaj Konvente do te jete fakultative per çdo Shtet, me kusht qe ne kohen e depozimit te instrumentit te saj te ratifikimit, pranimit, miratimit te kesaj Konvente ose aderimit ne te, ai Shtet do te njoftoje Depozituesin per pelqimin e tij per te qene Pale ne dy apo me shume prej ketyre protokolleve.
4. Ne çdo kohe, pas depozitimit te instrumentit te ratifikimit, pranimit, miratimit te kesaj Konvente ose te aderimit ne te, nje Shtet mund te njoftoje Depozituesin per pelqimin e tij per te pranuar detyrimet e ndonje protokollit shtese qe ai nuk i ka pasur me pare .
5. Secili protokoll qe eshte i detyrueshem per nje Pale te Larte Kontraktuese do te jete per ate Pale pjese integrale e kesaj Konvente.

Neni 5

Hyrja ne fuqi

1. Kjo Konvente do te hyje ne fuqi gjashte muaj pas dates se depozitimit te dokumentit te njezete te ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Per secilin Shtet qe depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit pas dates se depozitimit te dokumentit te njezete te ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, kjo Konvente do te hyje ne fuqi gjashte muaj nga data ne te cilen ai Shtet ka depozituar dokumentin e tij te ratifikimit, miratimit, pranimit ose aderimit.
3. Secili nga protokollet qe i shtohen kesaj Konvente do te hyje ne fuqi gjashte muaj pas dates ne te cilen njezet Shtete kane dhene pelqimin e tyre per te qene Pale ne te, ne perputhje me paragrafet 3 dhe 4 te nenit 4 te kesaj Konvente.
4. Per çdo Shtet qe njofton pelqimin per te qene Pale ne protokoll shtojce te kesaj Konvente pas dates ne te cilen njezet Shtete kane deklaruar pelqimin per te qene Pale ne te, Protokollin do te hyje ne fuqi gjashte muaj pas dates ne te cilen ai Shtet ka njoftuar pelqimin e tij per te qene Pale.

Neni 6

Propagandimi

Palet e Larta Kontraktuese marrin persiper si ne kohe paqeje, ashtu edhe ne gjate konflikteve te armatosura, te propagandojne sa me shume qe te jete e mundur ne vendet e tyre respektive kete Konvente, si edhe protokollet e saj shtese ne te cilat ato jane Pale dhe, ne menyre te vecante, te perfshijne studimin e tyre ne programet e pergatitjes ushtarake, me qellim qe keto dokumente te mund te behen te njohura per forcat e tyre te armatosura.

Neni 7

Marredheniet juridike pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente

1. Kur njera nga Palet ne nje konflikt nuk eshte Pale ne nje protokoll shtese, Palet e kesaj Konvente dhe te protokollit shtese do te kene detyrimet qe rrjedhin prej ketyre te fundit ne marredheniet e tyre reciproke.
2. Çdo Pale e Larte Kontraktuese do te kete detyrimet qe rrjedhin nga kjo Konvente dhe çdo protokoll shtese qe eshte ne fuqi per te ne çdo shtete te parashikuar nga neni 1, ne lidhje me çdo Shtet, i cili nuk eshte Pale e kesaj Konvente ose e protokollit perkates shtese, nese ky Shtet pranon dhe zbaton kete Konvente ose protokollin perkates dhe njofton per te kete qellim depozituesin.
3. Depozituesi duhet te informoje menjehere Palet e Larta Kontraktuese te interesuara per çdo njoftim te marre ne baze te paragrafit 2 te ketij neni.
4. Kjo Konvente dhe protokollet e saj shtese qe sjellin detyrime per nje Pale te Larte Kontraktuese, do te zbatohen ne çdo konflikt te armatosur kundrejt asaj Pale te Larte Kontraktuese te tipit te pershkruar ne nenin 1 paragrafi 4 te Protokollit 1 Shtese te Konventes se Gjeneves te dates 12 gusht 1949 "Per Mbrojtjen e Viktimave te Luftes": (a) nese Pala e Larte Kontraktuese eshte gjithashtu pale ne Protokollin 1 Shtese dhe autoriteti qe permendet ne nenin 96 paragrafi 3, te atij Protokollit ka marre persiper qe te zbatoje Konventat e Gjeneves dhe Protokollin 1 Shtese ne perputhje me nenin 96, paragrafi 3, te lartpermendur, si dhe merr persiper qe te zbatoje konventat e Gjeneves dhe Protokollin 1 shtese, ne perputhje me nenin 96 paragrafi 3 te Protokollit te lartpermendur, si dhe merr persiper te zbatoje kete Konvente dhe protokollet perkatese shtese ne lidhje me ate konflikt; ose

(b) nese Pala e Larte Kontraktuese nuk eshte Pale ne Protokollin 1 Shtese dhe nje autoritet i tipit te pershkruar ne nenparagrafin (a) te mesiperpranor dhe zbaton detyrimet qe rrjedhin nga Konventat e Gjeneves dhe nga kjo Konvente dhe protokollet perkatese shtese ne lidhje me ate konflikt. Nje pranim dhe zbatim i tille do te kete lidhje me ate konflikt pasojat e meposhtme:

(i) Konventat e Gjeneves dhe kjo Konvente e protokollet e saj shtese hyjne menjehere ne fuqi per palet ne konflikt;

(ii) Autoriteti i lartpermendur merr persiper te njejtat te drejta dhe detyrime me ato qe jane marre persiper nga nje Pale e Larte Kontraktuese ne Konventat e Gjeneves, kjo Konvente dhe protokollet perkatese shtese te saj; dhe

(iii) Konventat e Gjeneves, kjo Konvente dhe protokollet perkatese shtese te saj jane njesoj

te detyrueshme per te gjitha Palet ne konflikt.

Gjithashtu, Pala e larte Kontraktuese dhe autoriteti mund te bien dakord per te pranuar dhe zbatuar detyrimet qe rrjedhin nga Protokollin 1 Shtese i Konventave te Gjeneves mbi baza reciproke.

Neni 8

Rishikimi dhe amendamentet

1. (a) Ne çdo kobe, pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente, çdo Pale e Larte Kontraktuese mund te propozoje amendamente per kete Konvente ose per ndonje protokoll shtese qe sjell detyrime per te. Propozimi per amendamentin duhet t'i komunikohet Depozituesit, i cili do te njoftoje per kete qellim te gjitha Palet e Larta Kontraktuese dhe do te kerkoje pikepamjet e tyre nese duhet te mblidhet nje konference e cila te marre ne konsiderate propozimin ne fjale. Nese shumica, e cila nuk duhet te jete me e vogel se 18 prej Paleve te Larta Kontraktuese, bie dakord, ai do te therrase menjehere nje konference ku do te ftohen te gjitha Palet e Larta Kontraktuese. Shtetet qe nuk jane Pale ne kete Konvente do te ftohen ne konference si vezhgues.

(b) Nje Konference e tille mund te bjere dakord per amendamentet qe do te adaptohen dhe do te hyjne ne fuqi ne te njejten menyre si kjo Konvente dhe protokollet shtese, me kusht qe amendamentet e kesaj Konvente te adaptohen vetem nga Palet e Larta Kontraktuese dhe se amendamentet ne nje protokoll te veçante shtese te adaptohen verem nga Palet e Larta Kontraktuese, te cilat kane pranuar detyrimet e atij Protokolli.

2. (a) Ne çdo kohe pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente, çdo Pale e Larte Kontraktuese mund te propozoje protokolle shtese qe kane te bejne me kategori te tjera te armeve konvencionale, te cilat trajtohen ne protokollet shtese ekzistuese. Çdo propozim per protokoll shtese duhet t'i paraqitet Depozituesit, i cili duhet te njoftoje per kete qellim te gjitha Palet e Larta Kontraktuese, ne perputhje me nenparagrafin 1 (a) te ketij neni. Nese shumica, e cila nuk duhet te jete me e vogel se 18 Pale te Larta Kontraktuese, bie dakord atehere Depozituesi duhet te therrase menjehere nje konference ne te cilen do te ftohen te gjitha Shtetet.

(b) Nje Konference e tille, me pjesemarrjen e plote te te gjitha Shteteve te perfaqesuara ne te, mund te bjere dakord per protokollet shtese, te cilet do te miratohen ne te njejten menyre si kjo Konvente, do t'i shtohen kesaj te fundit dhe do te hyjne ne fuqi ne menyren e parashikuar ne paragrafet 3 dhe 4 te nenit 5 te kesaj Konvente.

3. (a) Ne qofte se pas nje periudhe prej dhjete vjtesh nga data e hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente nuk do te thirret asnje konference ne perputhje me nenparagrafin 1 (a) ose 2 (a) te ketij neni, çdo Pale e Larte Kontraktuese mund t'i kerkoje Depozituesit qe te organizojne nje konference ne te cilen do te ftohen te gjitha Palet e Larta Kontraktuese per te rishikuar fushen e veprimit dhe zbatimin e kesaj Konvente dhe te protokolleve shtese si dhe per te shqyrtuar çdo propozim per amendamente te kesaj Konvente ose te protokolleve ekzistuese. Shtete qe nuk jane Pale ne kete Konvente do te ftohen ne konference me statusin e vezhguesit. Konferenca mund te bjere dakord rreth amendamenteve te cilat do te adaptohen dhe qe do te hyjne ne fuqi ne perputhje me nenparagrafin 1 (b) te mesiperm.

(b) Gjithashtu, ne kete konference mund te shqyrtohet çdo propozim per protokolle shtese qe kane te bejne me kategori te tjera armesh konvencionale qe nuk trajtohen nga protokollat shtese ekzistuese. Te gjitha Shtetet e perfaqesuara ne konference mund te marrin pjese plotesisht gjate ketij shqyrtimi. Çdonjeri prej protokolleve shtese do te miratohet ne te njejten menyre si kjo Konvente, do t'i shtohet asaj dhe do te hyje ne fuqi ne menyren e parashikuar ne paragrafet 3 dhe 4 te nenit 5 te kesaj Konvente.

(c) Kjo Konference mund te marre ne konsiderate nese do te parashikohet mbajtja e nje konference te mevonshme me kerkesen e ndonje Pale te Larte Kontraktuese, ne qofte se pas nje periudhe te ngjashme me ate qe permendet ne nenparagrafin 3 (a) te ketij neni nuk eshte mbajtur asnje konference neperputhje me nenparagrafin 1 (a) dhe 2 (a) te po ketij neni.

Neni 9

Denoncimi

1. Çdo Pale e Larte Kontraktuese mund te denoncoje kete Konvente ose ndonje nga protokollat e saj shtese duke njoftuar per kete qellim Depozituesin.
2. Nje denoncim i tille do te hyje ne fuqi nje vit pas marrjes nga Depozituesi te njoftimit per denoncimin. Megjithate, ne qofte se me kalimin e ketij afati njevjeçar Pala e Larte Kontraktuese qe ben denoncimin eshte e angazhuar ne ndonje prej situatave qe permenden ne nenin 1, kjo Pale do te vazhdoje t'u permbahet detyrimeve te kesaj Konvente dhe protokolleve perkatese shtese te saj deri ne perfundim te konfliktit te armatosur ose te pushtimit dhe, ne çdo rast, deri ne perfundimin e operacioneve qe lidhen me lirimin perfundimtar, riatdhesimin ose rivendosjen ne vendin e tyre te personave qe mbrohen nga rregullat e se drejtes nderkombetare qe aplikohen ne konfliktin e armatosur. Ne rastin e çdo protokolli shtese qe permban dispozita ne lidhje me situatat ne te cilat forcat ose misionet e Kombeve te Bashkuara, kryejne ne terrenin ne fjale funksione paqeruajtese, vezhgime ose funksione te ngjashme ne to, Pala e mesiperme do te kete keto detyrime deri ne perfundimin e ketyre funksioneve.
3. Çdo denoncim i kesaj Konvente do te konsiderohet si i zbatueshem per te gjitha protokollat shtese qe sjellin detyrime per Palen e Larte Kontraktuese qe ben denoncimin.
4. Çdo denoncim do te kete efekt vetem per Palen e Larte Kontraktuese qe e ben ate.
5. Çdo denoncim nuk do te preke detyrimet qe jane marre persiper si pasoje e nje konflikti te armatosur ne baze te kesaj Konvente dhe protokolleve te saj shtese nga nje Pale Kontraktuese qe ben denoncimin ne lidhje me ndonje akt te kryer perpara se ky denoncim te behet efektiv.

Neni 10
Depozituesi

1. Sekretari i pergjithshem i Kombeve te Bashkuara do te jete Depozituesi i kesaj Konvente dhe i protokolleve te saj shtese.
2. Pervec funksioneve te tij te zakonshme, Depozituesi duhet te informoje te gjitha Shtetet mbi:
 - (a) nenshkrimet bashkengjitur kesaj Konvente ne pajtim me nenin 3;
 - (b) depozitimet e instrurnenteve te ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit te Konventes te depozituara ne perputhje me nenin 4;
 - (c) njoftimet mbi pelqimin per te pasur detyrimet e protokolleve shtese ne perputhje me nenin 4;
 - (d) datat e hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente dhe te secilit prej protokolleve te saj shtese ne perputhje me nenin 5; dhe
 - (e) njoftimet per denoncim te marra ne perputhje me nenin 9 dhe daten e hyrjes se tyre ne fuqi.

Neni 11
Tekstet autentike

Origjinali i kesaj Konvente, se bashku me protokollet shtese, te cilat jane tekste njelloj autentike ne gjuhen arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, do te depozitohen tek Depozituesi, i cili do t'u transmetoje te gjitha Shteteve kopjet origjinale te certifikuara.